

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë – Departamenti i Përfaqësimeve Gjyqësore, kundër të paditues ██████████ nga Ferizaj, Rr. ██████████ p.n., për shkak të pasurimit pabazë, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 15.03.2018, merrë këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** në tërësi, padia dhe kërkesëpadia e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, e ushtruar kundër të paditues ██████████ nga Ferizaj, për shkak të pasurimit pabazë në shumë prej 440.00€, si e pabazuar.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata me datë 25.01.2016 ka pranuar padinë e paditëses kundër të paditues ██████████ ██████████ nga Ferizaj, për shkak të pasurimit pa bazë, me bazë kontesti në vlerë prej 440.00 €.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe përkesëpadiës dhe konsiderojmë se Gjykata ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë se e paditura e ka tërhequr shumën në vlerë prej 440.00 €, prandaj edhe i propozoj Gjykatës që padinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Mëtej paditësja lidhur me pretendimet e të paditues se biznesi i regjistruar në emër të saj nuk ka qenë aktiv, deklaroi se provat e paraqitura nga e paditura nuk dëshmojnë se biznesi D.P.Z. ██████████ nuk ka qenë aktiv, por vetë dëshmon se biznesi i njejtë nuk ka obligime tatimore ndaj ATK-së.

E paditura në gjatë senacave dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sepse ne e kemi pasur biznesin e regjistruar, mirëpo

nuk kemi zhvilluar veprimtari biznesi dhe as nuk kemi krijuar asnjë fitim prej datës 01.01.2003 e tutje. Mëtej e paditura shton se provat e paraqitura pranë kësaj gjykate dëshmojnë se biznesi që nga regjistrimi e deri më tani nuk ka funksionuar asnjëherë dhe nuk kemi krijuar asnjëherë fitim nga ky biznes, ndërsa unë si paditëse nga dokumentacioni i paraqitur vërtetohet se gjendja ime shëndetësore është e rëndë edhe tani jemi të papunë. Andaj, meqenëse i mungojnë provat paditëses, e paditura i propozon Gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: vërtetimi i dt. 01.03.2006 në emër të firmës D.P.Z. "██████████" me nr. biznesi: 80247222; vërtetimi i dt.11.01.2008 në emër të firmës D.P.Z. "██████████" me nr. biznesi: 80247222; kërkesa për vërtetim tatimor e dt.27.02.2006; raporti nga poliklinika specialistike urologjike "Euromed" në Ferizaj, e dt.05.03.2017; raporti specialistik nga poliklinika "Pulsi" i dt.04.05.2012; raporti specialistik nga poliklinika "Pulsi" i dt.18.05.2012; rentgeni "Polmo" e dt.27.04.2016; raporti i EKG i dt.04.05.2012; raporti me analiza nga laborator "Pulsi"; raporti nga Qendra Emergjente e Spitalit në Ferizaj, me nr. protokollit: 1031, e dt.05.04.2013; raporti nga laborator "Pulsi" i dt.07.06.2012; raporti nga poliklinika "Rheuma" e dt.07.01.2010; raporti nga poliklinika "Rheuma" e dt.02.03.2013; raporti "Meka Tivka" i dt.14.11.2012; raporti kthyes nga laborator i dt.04.05.2012; raporti nga laborator "Internistika" i dt.04.05.2012; raporti nga pasqyra e llogarisë së Trustit; lista nga Qendra informative e llogarisë rrjedhëse nr. ██████████

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar nga shqyrtimi i provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga administrimi dhe shqyrtimi i provave, ka konstatuar këtë gjendje faktike: ekziston fakti se e paditura ka pranuar mjetet financiare nga paditësja në shumë prej 440.00 €, në llogarinë e saj rrjedhëse, të cilat mjete e paditura përmes Komisionit të saj profesional mjekësor

ia ka miratur të paditures në emër të pensionit invalidor. Poshtu u konstatua se e paditura në vitin 2003 e ka regjistruar biznesin në emër të saj me emrin D.P.Z. [REDAKTUAR], mirëpo nga të njetat prova, e sidomos vërtetimi i ATK-së i dt.01.03.2006 dhe pasqyra e llogarisë së Trustit në emër të biznesit D.P.Z. [REDAKTUAR] me pronare [REDAKTUAR]. Gjykata ka konstatuar se gjatë kohës së tërheqjes së pensionit invalidor nga e paditura, i njeiti biznes nuk ka qenë aktiv dhe nuk ka krijuar asnjë të ardhur financiare për të padituren [REDAKTUAR].

Gjykata nga arsyet e lartëcekura, ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pathemeltë, sepse në këtë rast nuk janë plotësuar elementet e ekzistimit të pasurimit të pabazë.

Andaj nga arsyet e lartëcekura, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 319 dhe 322 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së, me që asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e krijuara me fajin e palës tjetër.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.56/16, me datë 15.03.2018



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.